



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET  
MINISTRI**

**Luan MEMUSHI**

**PROGRAMI I LËNDËS**

**SË GJUHËS SHQIPE**

**KLASA III**

**CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE**

Tiranë, 2005

## I. HYRJE

Mësimi i gjuhës amtare në shkollë ka rëndësi të posaçme, sepse përmes tij aftësohet nxënësi për të krijuar dhe për të transmetuar nocione dhe informacione, të cilat janë të rëndësishme për kuptimin e vetvetes dhe të marrëdhënieve me botën. Gjuha amtare është mundësia themelore e kuptimit dhe e bashkëpunimit për krijimin e marrëdhënieve të mësipërme.

Mësimi i gjuhës shqipe, nisur nga ndikimi dhe rëndësia e tij, shtrihet përtej lëndës. Detyrë e tij themelore është zhvillimi i kujdesshëm dhe i vazhdueshëm si gjuhë vetjake, e përdorur në nivelin e vet më të mirë, në formën e vet standarde.

Synimi i mësimin të gjuhës shqipe në klasën e tretë si lëndë mësimore realizohet nëpërmjet përvetësimit të katër shprehive komunikuese të kuptueshmërisë: *të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, nëpërmjet *fitimit të disa njohurive bazë për gjuhën, që lidhen me sistemin e saj leksiko-gramatikor, me ushtrimin dhe zgjidhjen e situatave reale të komunikimit*.

Përmes drejtimeve të mësipërme realizohet përmbajtja e programit, në përputhje me moshën e nxënësve.

Përvetësimi i njohurive themelore për sistemin e gjuhës për tekstet letrare dhe joletrare, formimi kulturor, komunikimi, mirëkuptimi, argumentimi, mendimi kritik etj., janë kërkesa të rëndësishme të këtij programi, që ndikojnë dhe mundësojnë rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm e të veçantë të nxënësve.

## II. SYNIMI I LËNDËS

Qëllimi përfundimtar i mësimin të gjuhës shqipe në klasën e tretë është formimi i përgjithshëm gjuhësor i nxënësve, në kuptimin e përvetësimit më të mirë dhe me dëshirë të katërta shprehive komunikuese gjuhësore: *të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit*; në përvetësimin e njohurive themelore të sistemit të gjuhës, të teksteve letrare dhe joletrare; si dhe në krijimin intuitiv dhe konceptual të të gjitha lidhjeve dhe funksioneve gjuhësore, leksiko-gramatikore, kulturore, etike, shpirtërore etj.

## III. FUSHAT DHE NËNFUSHAT E STUDIMIT

**Fushat e studimit të gjuhës shqipe janë:**

- **Të dëgjuarit,**
- **Të folurit,**
- **Të lexuarit,**
- **Të shkruarit.**

### Nënfushat e studimit

Nr.	Të dëgjuarit dhe të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Njohuri rreth gjuhës
1.	Dhënie informacionesh, udhëzimesh, orientimesh	Lexim për të marrë informacion	Shkrimi funksional	Gramatikë: - Sintaksë - Morfologji
2.	Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	Lexim për të kuptuar pjesën e për të njohur	Shkrim personal	Kulturë gjuhësore

		idetë e shkrimtarit.		Leksikologji
3.	Paraqitja e përvojave vetjake dhe vlerësimi i përvoja të tjerëve	Lexim me dëshirë për zhvillimin e ndjenjave	Shkrimi me ndjenjë dhe imagjinatë.	Njohuri rreth gjuhës
4.	Të folurit rreth llojeve dhe gjinive letrare	Lexim për lloje dhe gjini të ndryshme letrare	Shkrimi i modeleve të ndryshme	Pikësim
5.	Të folurit dhe njohuri rreth gjuhës	Lexim me zë të lartë dhe sipas teknikës së recitimit	Estetika e shkrimit	Drejtshqiptim Drejtshkrim

#### IV. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e tretë synon:

- Ta aftësojë nxënësin të përdorë gjuhën amtare përmes kërkimit, shkëmbimit të ideve dhe informacioneve; të tregojë, të raportojë, të argumentojë e të zhvillojë ndjenjën e identitetit kombëtar.
- Të zhvillojë mendimin e pavarur të nxënësit, duke e nxitur për të zbuluar ide, për të mbajtur qëndrim, për të klasifikuar, për të krahasuar, për të vlerësuar dhe për të ngritur hipoteza.
- T'i nxisë nxënësit për të shprehur ndjenja nëpërmjet të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- T'i aftësojë nxënësit për të mbajtur qëndrim ndaj vlerave të veta dhe të shokëve, në marrjen e vendimeve, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj.
- T'i aftësojë nxënësit për të shkruar në modele të thjeshta dhe të larmishme në përshtatje me natyrën dhe moshën e tyre, të tilla si: *përshkrime, urime, kartolina, porosi, njoftime, këshilla, kërkesa, telegrame, lajmërim* etj.
- Të aftësohen nxënësit për dallimin e dukurive gjuhësore dhe përdorimin e rregullësive të saj drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore.

## V. OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Në përfundim të klasës së tretë, nxënësi duhet të fitojë shprehitë e mëposhtme:

Nr.	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Njohuri rreth gjuhës	Drejtshkrim
1.	Të dëgjojë me vëmendje të tjerët.	Të marrë pjesë në bashkëbisedim për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe udhëzime.	Të lexojë në mënyrë të tillë që të kuptojë informacionin që merr nga fusha të ndryshme.	Të shkruajë shënime të shkurtra të tipit: <i>këshillë, kartolinë, porosi, udhëzime</i> të thjeshta kur i kërkohen.	<b>Sintaksë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të kuptojë strukturën e tekstit.</li> <li>▪ Të dallojë fjalinë dëftore nga fjalia pyetëse dhe habitore.</li> <li>▪ Të dallojë 2 format e fjalisë së thjeshtë: pohore dhe mohore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të shkruajë sipas rregullave të drejtshkrimit.</li> <li>▪ Të shkruajë pa gabime tekste me të kopjuar, me diktim ose ato të krijuara nga vetë ai.</li> <li>▪ Të përdorë drejt shkronjën e madhe në nisjen e fjalisë.</li> <li>▪ Të vendosë shenjën e duhur të pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse dhe habitore.</li> <li>▪ Të përdorë drejt shenjat e pikësimit: <i>pikën, pikëpyetjen, pikëçuditësen</i> dhe vizën në dialog.</li> <li>▪ Të përdorë drejt shkronjën e madhe tek emrat e njerëzve, të qyteteve, lumenjve, fshatrave etj.</li> <li>▪ Të përdorë drejt në fjali <i>presjen</i> dhe lidhëzën <i>dhe</i>.</li> </ul>
2.	Të kuptojë dhe të interpretojë atë që dëgjon.	T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen dhe të bëjë edhe vetë pyetje për situata të ndryshme gjatë komunikimit. Të japë mendimin	Të lexojë për të kuptuar materialin që i jepet për qëllime të ndryshme. Ta interpretojë bukur atë që lexon.	Të shkruajë shkrime të thjeshta me të kopjuar dhe të diktuar. Te bëjë krijime të thjeshta duke përdorur gjuhë të qartë dhe të	<b>Morfologji</b> Të dallojë në mënyrë intuitive fjalët në fjali sipas klasave të mëposhtme: <i>emër, mbiemër, folje, ndajfolje</i> .	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të shkruajë drejt në numrin shumës emrat e gjinisë mashkullore të tipit: <i>hero, bari, mulli</i>.</li> <li>▪ Të shkruajë drejt emrat mashkulorë që në numrin shumës ndryshojnë temë.</li> <li>▪ Të shkruajnë drejt emrat <i>burrë,</i></li> </ul>

		e vet rreth atyre që dëgjon. Ta interpretojë sipas mënyrës së tij atë që dëgjon.		kuptueshme. Të shprehë me shkrim atë që dëgjon apo lexon.		<i>grurë, djathë</i> etj., në trajtën e pashquar. <ul style="list-style-type: none"> <li>Të shkruajë drejt në trajtën e shquar emrat e gjinisë femërore të tipit <i>çati, shami, shoqëri, lule</i>.</li> </ul>
3.	Të marrë pjesë aktive në bashkëbisedim.	Të shprehë qartë mendime, ndjenja, ide dhe përvoja vetjake me nisativë, si dhe kur i kërkohet nga të tjerët.	Të zhvillojë e të pasurojë dëshira, ëndrra e ndjenja vetjake, i nxitur nga leximet që bën.	Të shkruajë shkrime të shkurtra duke pasqyruar ndjenjat e veta dhe duke përdorur fantazinë. Të përshkruajë pamje, sende veprimtari, njerëz etj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të njohë kategoritë kryesore gramatikore të <i>emrit</i> (gjininë, numrin, trajtën) dhe të <i>mbiemrit</i> (gjininë, numrin, nyjëtimin).</li> <li>Të dallojë (me intuitë) kohën dhe vetën e foljeve (kohët e mënyrës dëftore: e pakryer, e tashme, e ardhme dhe e kryer e thjeshtë, nisur nga folje përfaqësuese të zgjedhimit I e II).</li> </ul>	Të shkruajë saktë në kohën e pakryer, të tashme e të ardhme të mënyrës dëftore foljet që mbarojnë me -t.  Të shkruajë drejt në kohën e kryer të thjeshtë foljet <i>marr, dal, jap</i> dhe <i>shoh</i> .  Të shkruajë saktë kohën e pakryer e të kryer të thjeshtë të foljeve <i>kam, jam</i> .
4.	Të tregohet i përqenduar në çështjet kryesore që diskutohen.	Të shprehet duke e përpunuar mendimin që shfaq. Të flasë duke u përqendruar në çështjet kryesore.	Të kuptojë idetë, mendimet dhe ndjenjat e shkrimtarit në pjesët që lexon. Të argumentojë duke u mbështetur në të dhënat e pjesës që lexon. Të nxjerrë çështjet kryesore që trajtohen në	Të shkruajë për qëllime të caktuara dhe për nevoja vetjake: <i>porosi, letra, kartolina, receta, kërkesa, lajmërimi, njoftime</i> etj.		Të shkruajë drejt mbiemrat që mbarojnë me -t, -ët, -të.

			pjesën që lexon.			
5.	Të ndjekë bashkëbiseduesin për të pasur mundësi t' i përgjigjet atij.	T' u përgjigjet qartë dhe me kuptim pyetjeve që i bëhen nga bashkëbiseduesi.	Të shprehë mendimin e vet për situatat që ndodhin në pjesët që lexon. Të analizojë me fjalë të thjeshta sjelljen dhe veprimet e personazheve kryesore në pjesët që lexon.	Të shkruajë pyetje dhe t' u përgjigjet me shkrim pyetjeve që i drejtohen. Të ritregojë me shkrim ato që lexon. Të shprehë me shkrim mendimet.		Të shkruajë drejt fjalët e gjata me mbi dy rrokje. Të shkruajë drejt fjalët: <i>asgjë, kurrjë, kurrkund, kurrsesi, askurrkund, kurrkush.</i>
6.	Të marrë informacione ta përdorë kur i nevojitet.	Të japë informacionin e duhur kur i kërkohet.	Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të fushave të ndryshme tematike.	Të modelojë shkrime të thjeshta të tipit: <i>letër, kartolinë përshkrim, udhëzim, këshillë, njoftim, kërkesë etj.</i>		Të shkruajë drejt fjalët me grupe zanoresh dhe bashkëtingëlloresh në trup të tyre.
7.	Të dëgjojë krijime në gjini e lloje të ndryshme letrare, si: <i>përralla, tregime, vjersha, fabula e gjëgjëza.</i>	Të shprehet në gjini e lloje të ndryshme letrare, si: <i>tregim, përrallë, vjershë, fabul e gjëgjëzë,</i> duke bërë edhe dallime ndërmjet tyre.	Të njohë gjini dhe lloje letrare të tilla, si: <i>përralla, tregimi, vjersha, fabula e gjëgjëza,</i> duke dalluar elementet e thjeshta gjuhësore që i dallojnë ato nga njëra-tjetra.	Të shkruajë <i>histori të thjeshta në gjini e lloje të ndryshme.</i>		
8.	Të respektojë interpretimet	Të sistemojë mendimet para se	Të njihet me gjuhën dhe	Ta ndërtojë saktë <i>tregimin,</i> duke u		

	<p>karakteristike në lloje e gjini të ndryshme letrare.</p>	<p>t'i shfaqë. Të interpretojë bukur pjesë nga lloje e gjini të ndryshme letrare.</p>	<p>veçoritë e veprave letrare. Të lexojë, të interpretojë, të recitojë dhe të luajë në role pjesë të thjeshta në prozë a poezi.</p>	<p>orientuar nga pyetjet, fjalët e figurat ndihmëse, si dhe nga strukturat gjysmë të gatshme. Të shkruajë hyrje dhe mbyllje tregimesh. T'i gjejë tituj të tjerë pjesës që lexon. Të përdorë gjatë të shkruarit fjalë e shprehje që i përkasin tematikës së shkrimit.</p>		
--	---	---	---	--	--	--

**VI. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT**  
**35 javë mësimi me 6 orë mësimi në javë = 210 orë gjithsej**

	<b>Linja</b>	<b>Orë</b>	<b>Nënljat</b>	<b>Orë</b>
<b>1.</b>	<b>GJUHË E FOLUR</b>	<b>15</b>		<b>15</b>
<b>2.</b>	<b>LEXIM</b>	<b>90</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Prozë e poezi</li> <li>▪ Përralla</li> <li>▪ Tregime</li> <li>▪ Fabula</li> <li>▪ Vjersha</li> <li>▪ Gjëe gjëza</li> <li>▪ Lexime (jashtë klase)</li> </ul>	<b>90</b>
<b>3.</b>	<b>GJUHË E SHKRUAR</b>	<b>25</b>	Gjuhë e shkruar	<b>25</b>
<b>4.</b>	<b>NJOHURI RRETH GJUHËS</b>	<b>60</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Sintaksë</li> <li>▪ Morfologji</li> <li>▪ Leksikologji</li> <li>▪ Drejtshkrim-pikësim</li> </ul>	<b>20</b> <b>20</b> <b>5</b> <b>15</b>
<b>5.</b>	<b>DISPOZICION</b>	<b>20</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Diktme</li> <li>▪ Përsëritje</li> <li>▪ Testime</li> </ul>	<b>20</b>



## VII. ZBËRTHIMI I PROGRAMIT SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

### LINJA: Të dëgjuarit e të folurit (15 orë)

Nënlinjat	Tematika	Objektivat	▪ Arritjet e pritshme
1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	☞ Tema nga jeta reale dhe veprimtaritë e përditshme: - <i>Loja, familja, shkolla, shoqëria, mjedisi;</i> - <i>Veprimtaritë sportive, koha e lirë, udhëtimet, televizori, interneti, biblioteka etj.;</i> - <i>Biseda në telefon;</i> - <i>Të rejat nga bota e fëmijëve.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përgjigjet qartë në përshtatje me atë që i kërkohet.</li> <li>• Të këshillojë dhe të japë informacione e mesazhe të shkurtra.</li> <li>• Të ndjekë radhën ose hapat e veprimeve që do të kryhen.</li> <li>• Të japë orientime të thjeshta, si: <i>urdhëra, udhëzime, porosi.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgjigjet shkurt e saktë për pyetjet që i bëhen.</li> <li>▪ Këshillon dhe jep informacione e udhëzime të thjeshta, pa ngatërruar radhën e veprimeve.</li> <li>▪ Dëgjon dhe pyet për gjëra që i interesojnë.</li> <li>▪ Jep urdhra, porosi dhe udhëzime të veçanta.</li> </ul>
2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	☞ Tema që lidhen me çështjet shoqërore, si: mbrojtja e mjedisit etj. ☞ Tema që u përkasin marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, si: - <i>Miqësia, mosmarrëveshjet, komunikimi, të drejtat, sjellja në grup, veprimtaritë e përbashkëta, paraqitjet;</i> - <i>Përshkrime të qyteteve, lagjeve e mjediseve ku jetojnë.</i> - <i>Hartime planesh për veprimtari në grup.</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dëgjojë dhe të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup.</li> <li>• Të diskutojë në grup për çështje të caktuara.</li> <li>• Të luajë role të thjeshta në grupe të vogla dhe të mëdha.</li> <li>• Të vlerësojë dhe të respektojë mendimet dhe idetë e shokëve duke i plotësuar me informacion shtesë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dëgjon me vëmendje bashkëbiseduesit.</li> <li>▪ Merr fjalën atëherë kur i jepet dhe hyn natyrshëm në bisedë.</li> <li>▪ Shfaq mendim dhe ndjenja të vetat rreth çështjeve që diskutohen.</li> <li>▪ Interpretin mirë.</li> <li>▪ Merr rolet në grupe të vogla dhe të mëdha.</li> <li>▪ Vlerëson mendimin e shokut në çift dhe në grup.</li> </ul>
3. Të dëgjuarit dhe të folurit	☞ Tema sipas gjinive e llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të flasë për tekste të ndryshme që janë në përshtatje me moshën e tij,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dëgjon me vëmendje dhe shpreh mendime vetjake rreth teksteve që lexon.</li> </ul>

<p>rreth teksteve të ndryshme</p>	<p>interes fëmijët, si: <i>përralla, tregime, vjersha, fabula e gjëgjëza</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Biseda për tekste të ndryshme që kanë lexuar ose kanë dëgjuar.</li> <li>☞ Blloqe pyetjesh për tekste të ndryshme letrare dhe joletrare.</li> <li>☞ Argumentime të situatave të caktuara që hasen në librat që kanë lexuar apo emisionet që kanë parë.</li> <li>☞ Sjellje e përvojave të ngjashme me ato të personazheve.</li> </ul>	<p>që kanë strukturë dhe gjuhë të gjetur (tregime, vjersha, përralla, fabula etj.).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• T'u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së teksteve dhe figurave që shikon..</li> <li>• Të dallojë ndryshimet e thjeshta gjuhësore në tekstet që lexon.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpreh pëlqim ose jo për pjesët e dëgjuara apo të lexuara.</li> <li>▪ Drejton pyetje për detaje të ndryshme të përmbajtjes, për personazhet etj., të pjesëve të dëgjuara apo të lexuara.</li> <li>▪ Përshekruan tipare të personazheve duke i krahasuar ato.</li> </ul>
<p>4. Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Diskutime për gjini të veçanta letrare, si: <i>vjersha, përralla, tregime dhe gjëgjëza</i>.</li> <li>☞ Rrëfim i përrallave;</li> <li>☞ Recitim i vjershave;</li> <li>☞ Pjesëmarrje në lojën me role;</li> <li>☞ Vlerësim i lojës së njëri-tjetrit;</li> <li>☞ Drejtim pyetjesh dhe marrje përgjigjesh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë dhe të krahasojë me njëra-tjetrën llojet dhe gjinitë e mëposhtme letrare: vjershën, përrallën, tregimin, fabulën dhe gjëgjëzën.</li> <li>• Të ndryshojë intonacionin e zërit në një vjershë, përrallë dhe tregim.</li> <li>• Të gjejë titull, hyrje dhe mbyllje të reja në një përrallë ose tregim.</li> <li>• Të interpretojë pjesë të ndryshme sipas llojit që ato përfaqësojnë</li> <li>• Të fitojë një teknikë recitimi të qartë, të saktë dhe të pëlqyeshme për të tjerët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ I njeh dhe i dallon llojet dhe gjinitë letrare nga njëra-tjetra: <i>përrallën nga tregimi, vjershat e gjëgjëzat</i>.</li> <li>▪ Dallon llojin e pjesës që lexon apo dëgjon, nisur nga intonacioni dhe fjalët karakteristike të përdorura në të.</li> <li>▪ Gjen titull, hyrje dhe mbyllje të reja në pjesët që dëgjon dhe lexon.</li> <li>▪ Interpreton pjesë të ndryshme sipas llojit që ato përfaqësojnë.</li> <li>▪ Zotëron teknikë recitimi të qartë, të saktë dhe të pëlqyeshme nga të tjerët.</li> </ul>
<p>5. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë nga fusha të veprimtarisë jetësore të fëmijëve.</li> <li>☞ Pasurimi i fjalorit me shprehje dhe terma nga fusha të ndryshme tematike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shqiptojë saktë tingujt dhe fjalët.</li> <li>• Të njohë kuptimin e parë të fjalëve më të përdorshme.</li> <li>• Të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje karakteristike, në përshtatje me fushat tematike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njeh kuptimin e fjalëve e të shprehjeve të reja.</li> <li>▪ Përdor emërtime të sakta, si: <i>përrallë, tregim, vjershë, titull, varg, rresht, hyrje e mbyllje</i>.</li> </ul>

## LINJA: TË LEXUARIT\* (90orë)

Kërkohet të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe e huaj në përshtatje me moshën e fëmijëve të klasës së tretë, të cilat të plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës.

Të përfaqësohen pjesë nga tradita, nga e kaluara, e sotmja dhe fantazia për të ardhmen përmes raporteve të drejta, ku vendin kryesor ta zënë pjesë që pasqyrojnë të sotmen dhe pjesë që zhvillojnë fantazinë për të ardhmen.

Raportet të përfaqësohen sipas ndarjeve të mëposhtme.

- 20% pjesë me përmbajtje nga e kaluara.
- 50% pjesë me përmbajtje nga e sotmja dhe veprimtaria jetësore e përditshme, aventurat dhe “bëmat” e fëmijëve sot, të drejtat e fëmijëve etj.
- 30% pjesë që zhvillojnë fantazinë për të ardhmen në fusha të ndryshme të veprimtarisë jetësore të fëmijëve: *hapësira, shkenca, informacione për mjedisin etj.*

Përsa i përket raportit ndërmjet teksteve letrare me tekstet joletrare të ruhet 80% për të parat dhe 20% për të dytat.

Për lexime jashtë klase të parashikohen botime të përshtatshme dhe të pëlqyeshme për moshën. Raporte të drejta të vendosen edhe për përfaqësimin e letërsisë shqipe me letërsinë e huaj, e pakta 70% me 30% në të mirë të letërsisë shqipe.

Nënlinja	Tematika	Objektivat	Arritjet e pritshme
1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	☞ Tekste letrare dhe joletrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë duke treguar se e kupton tërësisht përmbajtjen e pjesës.</li> <li>• Të bëjë pyetje rreth tekstit që ka lexuar për të treguar se e ka kuptuar.</li> <li>• Të japë detaje shtesë rreth informacionit apo udhëzimit të marrë, duke e pasuruar atë më tej.</li> <li>• Të zgjerojë me detaje shtesë informacionin e marrë nga burime të ndryshme, si: libri, TV, video, interenti etj., si dhe nga kanale të tjera informacioni.</li> <li>• Të japë udhëzime të thjeshta rreth mënyrës më të mirë të lexuarit të teksteve që japin informacione, porosi, udhëzime për veprimtari të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon me shpejtësinë e duhur.</li> <li>▪ Lexon duke treguar se e kupton përmbajtjen e informacioneve të ndryshme.</li> <li>▪ Drejton pyetje për marrje të të dhënave shtesë.</li> <li>▪ Formulon udhëzime për tema për të cilat ka lexuar më parë.</li> <li>▪ Shton dhe zbërthen detaje në informacionet që merr.</li> <li>▪ Respekton udhëzimet e dhëna,</li> </ul>

			instruksionet dhe procedurat e veprimeve.
2. Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Pjesë që u ngjallin nxënësve emocione, dëshirë për t'i lexuar deri në fund dhe u zhvillojnë ndjenja pozitive me tema nga: <i>shkolla, loja, fitorja, dashuria, veprimtaritë jashtëshkollore, bashkëpunimi, besa, ndihma, ndershmëria besnikëria etj.</i></li> <li>☞ Pjesë ku nxënësit gjejnë miqtë e tyre të tregimeve dhe të përrallave.</li> <li>☞ Tekste që përmbajnë fabula interesante, që i nxisin ata të tregojnë histori të ngjashme, ëndrra etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të lexojë me dëshirë, interes, emocion dhe me ndjenjë tekste të natyrave të ndryshme.</li> <li>▪ Të dallojë dhe të analizojë tiparet e personazheve që pëlqen, duke e mbështetur mendimin me argumente të thjeshta.</li> <li>▪ Të bashkëbisedojë me personazhet e dashura për dëshira të përbashkëta.</li> <li>▪ Të krijojë lidhje ndërmjet filmave, figurave dhe historive të lexuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ka motive të dukshme për të lexuar. Ndjek e respekton udhëzimet, kërkon dhe sjell libra jashtë klase, dëshiron t'ua bëjë të njohur shokëve përmbajtjen e tyre.</li> <li>▪ I lexon pjesët me emocion dhe i përfshirë tërësisht në to.</li> <li>▪ Gjen pika të përbashkëta me personazhet e pjesëve që lexon.</li> <li>▪ Përshkruan dhe rrëfen tregime dhe përralla me ndjenjë dhe emocion.</li> </ul>
3. Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Tekste letrare dhe joletrare të pasura me të dhëna e detaje kryesore, që i nxjerrin qartë idetë dhe mesazhet që përmbajnë.</li> <li>☞ Tekste që përshkruajnë mjedise dhe njerëz që marrin pjesë në to.</li> <li>☞ Tekste që i motivojnë nxënësit t'i bëjnë të njohura idetë në mënyra të ndryshme: <i>me anë të</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të tregojë brendinë e pjesës që lexon.</li> <li>▪ Të rendisë dhe të nxjerrë pikat e planit.</li> <li>▪ Të kuptojë mesazhin e pjesës që lexon.</li> <li>▪ Të shfaqë mendime të vetat nëse tema e pjesës që lexon, ka lidhje me botën dhe interesat e tij.</li> <li>▪ Të analizojë personazhin kryesor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nxjerr idenë kryesore dhe mesazhe të pjesëve që lexon.</li> <li>▪ Drejton pyetje për detaje dhe çështje që i interesojnë gjatë dhe pas leximit të pjesës.</li> <li>▪ Ritregon përmbajtjen e pjesëve në mënyrë të përmbledhur, duke dhënë detajet kryesore.</li> <li>▪ Shpreh mendime të sakta nëse pjesët lidhen ose jo me interesat dhe botën e tij.</li> </ul>

	<i>dramatizimeve, recitimeve, vizatimeve, diagrameve, shkrimeve, poezive, konkurseve etj.</i>		
4. Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Pjesë të llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare, si: përralla, tregime, vjersha, drama dhe gjëegjëza.</li> <li>☞ Pjesë në të cilat dallohen tipare të llojeve e gjinive të ndryshme që nga mënyra e organizimit të faqes, të përzgjedhjes së figurave, gjuhës, titullit, paragrafëve, vargut, dialogut etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përzgjedhë për të lexuar pjesë që u përkasin llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare.</li> <li>• Të respektojë elemente të stilit dhe të gjuhës, të tilla si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu.</li> <li>• Të bëjë dallimin ndërmjet vjershës nga tregimi, përrallës dhe gjëegjëza etj.</li> <li>• Të shprehë pëlqimin ose mospëlqimin për lloje e gjini të veçanta.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjen llojin e gjinisë që u përkasin pjesët e lexuara.</li> <li>▪ Dallon elemente të stilit dhe të gjuhës, të tilla, si: <i>paragrafi, rreshti, strofa, vargu</i>.</li> <li>▪ Dallon vjershën nga tregimi, përrallën nga gjëegjëza etj.</li> <li>▪ Përcakton llojin e gjinisë që pëlqen.</li> </ul>
5. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Pjesë që, duke u lexuar me zë të lartë, ngjallin emocion te dëgjuesit.</li> <li>☞ Pjesë të transmetuara në radio e televizion që duhen imituar nga nxënësit (tempo, ritmi, theksi).</li> <li>☞ Pjesë që, kur recitohen apo interpretohen në role, ngjallin emocione tek nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të respektojë intonacionin e duhur gjatë leximeve me zë të lartë të pjesëve në poezi apo në prozë.</li> <li>• Të recitojë bukur, qartë e më zë të lartë vjershat që i kërkohen.</li> <li>• Të luajë në role figura të personazheve të tregimeve dhe të përrallave që ka lexuar.</li> <li>• Të imitojë zërin e një personi që flet në një transmetim veprimtarie sportive, në një emision TV, reklamë, film etj.).</li> <li>• Të luajë në role personazhin që pëlqen më shumë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon me zë të lartë dhe në heshtje pjesët, në varësi të llojit të tyre.</li> <li>▪ Reciton përmendësh vjersha të shkurtra, si dhe pjesë në prozë.</li> <li>▪ Imiton personazhe të dashura.</li> <li>▪ Luan në role pjesë të ndryshme dramatike, të përshtatshme për moshën.</li> </ul>
6. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	☞ Pjesë dhe tekste që pasurojnë të folurit e nxënësve me terma të tillë, si: <i>autor, titull, faqe, vjershë, strofë, varg,</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë e të dallojë terma të tillë, si: <i>autor, titull, faqe, vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, njoftim etj.</i> në pjesët që lexon.</li> <li>• Të respektojë gjatë të lexuarit shenjat e pikësimit: <i>pikën,</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njeh dhe përdor terma specifikë, si: <i>autor, titull, faqe, vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje,</i></li> </ul>

	<i>tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëgjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, njoftim, rol, fjalor, dialog, mesazh, pikë kulmore.</i>	<p><i>pikëpyetjen dhe pikëçuditësen.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojë të gjitha fjalët e teksteve që lexon.</li> <li>• Të shpjegojë kuptimin fjalëve figurative e të shprehjeve që ndesh në tekstet që lexon.</li> </ul>	<p><i>personazh, hyrje, mbyllje, ide, mesazh, kuptim i figurshëm, shprehje figurative etj., në pjesët që lexon.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon me intonacion duke respektuar shenjat e pikësimit.</li> <li>▪ Njeh kuptimin e parë, si dhe kuptimet e figurshme të fjalëve të reja që ndesh në një tekst.</li> </ul>
--	--	---	---

### LINJA: Të shkruarit (25 orë)

Nënlinja	Tematika	Objektivat	Arritje të pritshme
1. Të shkruarit funksional	<p>☞ Modele shkrimesh me karakter funksional të tilla, si: <i>njoftime, udhëzime orientime dhe porosi të thjeshta, receta, skeda, lajmërim, kërkesa.</i></p> <p>☞ Fragmente shkrimesh nga revistat dhe gazetat për fëmijë që përmbajnë shkrime të karakterit funksional, si: bileta, harta, guida.</p> <p>☞ Modele gjysmë të gatshme në të cilat nxënësit do të plotësojnë fjalët dhe shprehjet që mungojnë, si: <i>tekste, lojëra gjuhësore etj.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë me të kopjuar, me të plotësuar apo me diktim saktë, qartë e kuptueshëm <i>udhëzime, njoftime, orientime e porosi</i> të thjeshta.</li> <li>• Të shkruajë këshilla e porosi të thjeshta për të tjerët.</li> <li>• Të mbajë shënime të shkurtra për udhëzime, porosi e njoftime që i interesojnë të dhëna përmes telefonit apo bisedave të drejpërdrejta.</li> <li>• Të plotësojë saktë modelet gjysmë të gatshme duke u ndihmuar nga fjalë apo pyetje ndihmëse.</li> <li>• Të shpjegojë shkurt orinetime përmes guidave dhe hartave të thjeshta.</li> <li>• Të shkruajë programe të thjeshta për veprimtari të përbashkëta.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kopjon e shkruan saktë <i>udhëzime, njoftime, orientime, skeda, lajmërim, kërkesa porosi</i> të thjeshta.</li> <li>▪ Mban shënime të thjeshta e të shkurtra për gjëra që i interesojnë.</li> <li>▪ Shkruan njoftime, udhëzime dhe porosi sipas të gjitha rregullave të shkrimit.</li> </ul>
2. Të shkruarit për nevoja vetjake	<p>☞ Modele <i>letrash të thjeshta për veten dhe të tjerët.</i></p> <p>☞ Modele <i>urimesh e kartolinash</i> të dërguara në raste të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kopjojë saktë modele urimesh, kartolinash e letrash.</li> <li>• Të shkruajë vetë <i>një urim, kartolinë dhe një letër të thjeshtë.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shkruan urime, kartolina e letra të thjeshta në mënyrë të pavarur.</li> <li>▪ Shkruan fletë ditari.</li> <li>▪ Përshkruan shkurt, por me dateje</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ <i>Histori dhe përvoja vetjake të fëmijëve të kësaj moshe.</i></li> <li>☞ <i>Modele ditaresh të thjeshta.</i></li> <li>☞ <i>Plane të thjeshta të bashkëmoshatarëve.</i></li> <li>☞ <i>Orare veprimtarish.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë fletë ditari duke imituar modele, si dhe duke krijuar vetë.</li> <li>• Të shkruajë për gjërat që i bëjnë më tepër përshtypje nga jeta e përditshme.</li> <li>• Të përshkruajë me detaje të thjeshta e të qarta histori e përvoja vetjake i ndihmuar nga pyetjet: <i>Kush?, Cili?, Çfarë?, Si?, Me kë?, Kur?, Ku?</i> etj.</li> <li>• Të hartojë plane të thjeshta të regjimit ditor të veprimtarive në fundjavë apo për ditët e veprimtarive shkollore.</li> </ul>	<p>histori vetjake.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Harton planin e vet ditor.</li> </ul>
3. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ <i>Tekste me portrete njerëzish dhe pamje nga pejsazhi i natyrës dhe mjedise të ndryshme.</i></li> <li>☞ <i>Përshkrime pikturash dhe fotografish që nxisin imagjinatën e nxënësve.</i></li> <li>☞ <i>Tekste për personazhe fantastike me fuqi mbinatyrore, të dashura për fëmijët, si: supermen, jashtëtokësorë, Pinoku, dinozauri, Tomi e Xherri, Shreku, Harri Potter e të tjerë.</i></li> <li>☞ <i>Personazhe historikë apo të përrallave: Skënderbeu, Kacamicri, xhuxhmaxhuxhët.</i></li> <li>☞ <i>Përshkrimi i kafshëve nga fabula të njohura, si: ujku, luani etj.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përshkruajë shokë, miq, të afërm, objekte, sende e kafshë të njohur e të dashur për të me detaje që përfshijnë edhe pamjen e jashtme e cilësi të tjera.</li> <li>• Të përshkruajë me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje, poster apo një fotografi.</li> <li>• Të shkruajë histori imagjinare rreth bëmave të personazheve fantastike, si: supermeni, ufo, kuçedra, shtriga, Hirushja, Pinoku, Batman, dinozauri, Tomi e Xherri, Shreku, Harri Potter etj.</li> <li>• Të shkruajë mbyllje të tjera të një historie.</li> <li>• Të shkruajë tregime të shkurtra, orientuar nga figura, modele dhe fjalë kyçe.</li> <li>• Të krahasojë me shkrim një personazh pozitiv ose negativ.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkruan shkurt dhe me ndjenjë njerëz të njohur, sende dhe objekte vetjake, kafshë të dashura.</li> <li>▪ Përshkruan piktura, fotografi, duke vënë në punë imagjinatën.</li> <li>▪ Krijon histori me personazhe, që ndikojnë për mirë ose për keq në jetën e fëmijëve.</li> <li>▪ Krijon tregime të thjeshta sipas imagjinatës.</li> </ul>
4. Njohuri rreth gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ <i>Pjesë dhe tekste që i familjarizojnë nxënësit me terma të tillë, si: udhëzim, njoftim, letër, porosi, kartolinë, personazh</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë fjalët dhe termat e duhur në një <i>udhëzim, urim, kartolinë, letër, krijim, përshkrim, titull, shenja pikësimi, krahasim, porosi, recetë, kërkesë etj.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përzgjedh saktë fjalët e duhura gjatë shkrimit të një <i>udhëzuesi, urimi, kartoline, letre, krijimi etj.</i></li> </ul>

	<i>fantastik, histori, krijim, titull, mbyllje, hapje, mbyllje, paragraf, fjali, fjalë të gjata, emra njerëzish etj.</i>		
--	--	--	--

**LINJA: Njohuri rreth gjuhës (60 orë)**

<b>Nënlinja</b>	<b>Tematika</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Arritjet e pritshme</b>
Sintaksë (20 orë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Teksti dhe fjalia</li> <li>▪ Llojet e fjalive (dëftore, pyetëse, habitore)</li> <li>▪ Fjalia pohore dhe mohore</li> <li>▪ Grupet kryesore në fjali</li> <li>▪ Pyesim për grupet kryesore me Kush? dhe Ç'bën?</li> <li>▪ Shndërrime brenda fjalisë</li> <li>▪ Grupe fjalësh të qëndrueshme</li> <li>▪ Grupet fjalësh të lëvizshme</li> <li>▪ Grupet fjalësh të domosdoshme dhe jo domosdoshme</li> <li>▪ Fjalia më e vogël</li> <li>▪ Grupet e fjalëve plotësuese</li> <li>▪ Përshtatja e foljes me kryefjalën</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë ç'është teksti.</li> <li>• Të dallojë paragrafët dhe fjalitë në një tekst.</li> <li>• Të njihet me strukturën e fjalisë.</li> <li>• Të zhvendosë fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj.</li> <li>• Të shtojë dhe të heqë fjalë në një fjali të thjeshtë pa prishur kuptimin e saj.</li> <li>• Të njohë fjalinë dëftore, pyetëse dhe habitore.</li> <li>• Të njohë fjalinë pohore dhe mohore.</li> <li>• Të njohë e të dallojë grupet kryesore në fjali.</li> <li>• Të njohë e të dallojë grupet plotësuese në fjali</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon paragrafët dhe fjalitë në një tekst.</li> <li>▪ Ndërton fjali duke respektuar strukturën e saj.</li> <li>▪ Zhvendos fjalët në një fjali të thjeshtë pa e prishur kuptimin e saj.</li> <li>▪ Zgjeron dhe zvogëlon fjali pa ndryshuar e pa prishur kuptimin e saj.</li> <li>▪ Dallon fjalinë dëftore, pyetëse dhe habitore.</li> <li>▪ Dallon fjalinë pohore dhe mohore.</li> <li>▪ Dallon fjalët kryesore në fjali me ndihmën e pyetjeve <i>Kush?</i>, <i>Cili?</i>, <i>Çfarë bën ...?</i></li> </ul>
Morfologji (20 orë)	<p><b>Emri</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm</li> <li>• Gjinia e emrit</li> <li>• Numri i emrit</li> <li>• Trajta e emrit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë fjalë që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh.</li> <li>• Të dallojë emrat e gjinisë femërore nga të gjinisë mashkullore nisur nga mbaresat e tyre.</li> <li>• Të dallojë emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njohje e emrave specifikë që tregojnë njerëz, sende dhe kafshë.</li> <li>▪ Dallimi i emrave të gjinisë femërore dhe mashkullore.</li> <li>▪ Dallimi i emrit në numrin njëjës dhe shumës.</li> </ul>



	<p><b>Folja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjedhimi i foljes</li> <li>• Koha e tashme e foljes</li> <li>• Koha e ardhme e foljes</li> <li>• Koha e pakryer e foljes</li> <li>• Koha e kryer e thjeshtë e foljes</li> <li>• Lidhja e foljes me kryefjalën</li> </ul> <p><b>Ndajfolja</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë kohën e tashme të foljeve.</li> <li>• Të zgjedhë foljet në kohën e ardhme.</li> <li>• Të zgjedhë foljet në kohën e pakryer dhe të kryer të thjeshtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallimi i fjalëve që tregojnë veprim.</li> <li>• Zgjedhon foljet në kohën e tashme, të ardhme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon ndajfojen</li> </ul>
Leksikologji (5 orë)	<p><b>Fjalëformim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Fjalë me parashtesa dhe prapashtesa</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë e të dallojë fjalë të thjeshta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallim i fjalëve të thjeshta dhe i fjalëve me parashtesa dhe prapashtesa.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Fjalët sinonimike dhe antonimike</li> <li>☞ Shprehjet frazeologjike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjejë fjalë sinonimike me fjalët e dhëna.</li> <li>• Të gjejë fjalë antonimike të fjalëve të dhëna.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjetje deri në 2 të fjalëve sinonimike me fjalët e dhëna.</li> <li>▪ Gjetje deri në 2 të fjalëve antonimike me fjalët e dhëna.</li> </ul>
Drejtshkrim (15 orë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Shenjat e pikësisimit ., ?, !.</li> <li>☞ Shkrimi i fjalëve mohuese <i>nuk</i> dhe <i>s'</i></li> <li>☞ Shkrimi i fjalëve mohuese askush, kurrkush, asnjë, asnjëri, asnjëra, askurrkush, kurrkund, kurgjë etj.</li> <li>☞ Shkrimi i foljeve në kohën e tashme</li> <li>☞ Drejtshkrimi i foljeve që mbarojnë me –t në kohën e tashme</li> <li>☞ Drejtshkrimi i foljeve që mbarojnë me –t në kohën e ardhme</li> <li>☞ Drejtshkrimi i foljeve që mbarojnë me –t në kohën e pakryer</li> <li>☞ Drejtshkrimi i foljeve të parregullta : marr, dal, jap, shoh etj.</li> <li>☞ Drejtshkrimi i foljeve kam e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë drejt shenjat e pikësisimit ., ?, !.</li> <li>• Të shkruajë saktë fjalët mohuese <i>nuk</i> dhe <i>s'</i>.</li> <li>• Të shkruajë saktë mohuese askush, kurrkush, asnjë, asnjëri, asnjëra, askurrkush, kurrkund, kurgjë etj.</li> <li>• Të drejtshkruajë foljet e kohës së tashme që mbarojnë me –t.</li> <li>• Të drejtshkruajë foljet që mbarojnë me –t në kohën e ardhme.</li> <li>• Të drejtshkruajë foljet që mbarojnë me –t në kohën e pakryer.</li> <li>• Të drejtshkruajë foljet e parregullta: marr dal, jap etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përdor drejt shenjat e pikësisimit ., ?, !.</li> <li>▪ Shkruan saktë fjalët mohuese <i>nuk</i> dhe <i>s'</i>.</li> <li>▪ Shkruan saktë mohuese askush, kurrkush, asnjë, asnjëri, asnjëra, askurrkush, kurrkund, kurgjë etj.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë foljet që mbarojnë me –t në kohën e tashme.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë foljet që mbarojnë me –t në kohën e ardhme.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë foljet që mbarojnë me –t në kohën e pakryer.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë foljet të parregullta: marr dal, jap etj.</li> </ul>

	<p>jam në kohën e pakryer dhe të kryer të thjeshtë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Drejtshkrimi në numrin shumës i emrave mashkullorë të tipit: hero, mulli, bari</li> <li>☞ Drejtshkrimi në trajtën e shquar të emrave femërorë të tipit: çati, shoqëri, shami</li> <li>☞ Drejtshkrimi ndajfoljeve</li> <li>☞ Drejtshkrimi i mbiemrave që mbarojnë me -t, -et, -ët</li> <li>☞ Ushtrime drejtshkrimore</li> <li>☞ Dikttime dhe kopjime tekste sh.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të drejtshkruajë foljet kam e jam në kohën e pakryer dhe të kryer të thjeshtë.</li> <li>● Të drejtshkruajë emrat e përveçëm.</li> <li>● Të drejtshkruajë emrat mashkullorë në numrin shumës.</li> <li>● Të drejtshkruajnë ndajfoljet</li> <li>● Të drejtshkruajë mbiemrat që mbarojnë me -t, -et, -ët.</li> <li>● Të kopjojnë tekste të ndryshme.</li> <li>● Të drejtshkruajë gjatë dikttimeve e vetëdikttimeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtshkruajnë foljet në kohën e kryer të thjeshtë.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë emrat e përveçëm.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë emrat mashkullorë në numrin shumës.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë ndajfoljet.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë mbiemrat që mbarojnë me -t, -et, -ët.</li> <li>▪ Kopjojnë tekste.</li> <li>▪ Drejtshkruajnë tekste nëpërmjet dikttimeve, vetëdikttimeve etj.</li> </ul>
--	---	--	--

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

### Parime për mësimin e gjuhës shqipe

#### A. PARIME TË PËRGJITHSHME

- Mësimi i gjuhës shqipe në arsimin fillor të ruajë dhe të respektojë karakterin e vet kombëtar.
- Mësimi i gjuhës amtare të pasqyrojë elementet më të përparuara, duke i bashkuar ato edhe me elemente të reja të dokumentacionit lëndor.
- Mësimi i gjuhës shqipe të pasurojë të folurit e nxënësve dhe të ndikojë në rritjen e forcimit të ndërgjegjes së tyre gjuhësore.
- Mësimi i gjuhës shqipe të ndihmojë në formimin e përgjithshëm human dhe intelektual të çdo nxënësi.
- Mësimi i gjuhës shqipe të pasqyrojë përmasat dhe arritjet e sotme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

#### B. PARIME SHKEN CORE

- Mësimi i gjuhës shqipe zhvillohet përmes 4 shprehive komunikuese: *të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit*. Përmes mësimin të gjuhës shqipe nxitet përvetësimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve për shprehitë bazë të sistemit të gjuhës, të domosdoshme për ta artikuluar gjuhën në të gjitha shprehitë e saj komunikuese.
- Mësimi i gjuhës shqipe të lidhet ngushtësisht me të gjitha shprehitë komunikuese.
- Mësimi i gjuhës amtare të përcjellë zhvillimet e reja të gjuhës dhe të ligjeve të zhvillimit të saj të brendshëm e të jashtëm.
- Mësimi i gjuhës amtare të jetë në qendër të çdo lënde shkollore dhe të vlerësohet si një proces, objektivat e të cilit janë detyrim për çdo lëndë shkollore.

#### C. PARIME DIDAKTIKE

- Mësimi i gjuhës shqipe në shkollën fillore të mbështetet në natyrën intuitive të fëmijëve për trajtimin e dukurive gjuhësore.
- Mësimi i gjuhës shqipe në shkollën fillore të ketë karakter të theksuar praktik.
- Mësimi i gjuhës shqipe të ketë në qendër zhvillimin dhe përdorimin e metodave dhe të strategjive të reja të didaktikës bashkëkohore.
- Natyra e të mësuarit të gjuhës shqipe në shkollë ta kthejë mësimdhënien me fëmijën në qendër.
- Mësimi i gjuhës shqipe të zhvillohet përmes përdorimit të materialeve autentike (të riciklueshme), përfshirë këtu materiale të medias së shkruar dhe të folur, televizorit, radios, kompjuterit etj.

#### D. PARIME SPECIFIKE TË ORGANIZIMIT TË STRUKTURËS DHE TË PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndër parimet, në të cilat mbështetet organizimi strukturor dhe përmbajta e lëndës së gjuhës shqipe, veçojmë:

- Parimin linear,
- Parimin koncentrik dhe
- Parimin e integritit (brenda lëndës dhe ndër lëndor).

## INTEGRIMI

- ☞ Tekstet e gjuhës shqipe dhe të leximit të jenë të integruara së bashku.
- ☞ Këto tekste të realizojnë në nivele me të mira lidhjen ndërmjet leximit dhe gjuhës, ndërmjet shprehjeve komunikuese të përmendura me lart dhe njohurive më të domosdoshme për gjuhën që fitohen, mësohen dhe ushtrohen përmes kësaj lënde.
- ☞ Integrimi ndërmjet gjuhës shqipe dhe leximit të vështrohet e të realizohet si një domosdoshmëri me vlerë që përcjell një risi për këtë lëndë.
- ☞ Gjatë realizimit të integritit në tekstin e gjuhës shqipe, të mbahen parasysh:
  - Integrimi ndërmjet *lëndëve që deri tani janë trajtuar më vete, i gjuhës shqipe-3 dhe i leximit-3*;
  - Integrimi ndërmjet *fushave të studimit* (linjave dhe nënlinjave);
  - Integrimi *në planin e bashkëveprimit të objektivave për secilën fushë*;
  - Integrimi *në përdorimin e metodave ndërvepruese në mësimdhënie*;
  - Integrimi përmes *zbërthimit të përmbajtjes lëndore të fushave të veprimtarisë së nxënësit (të mësuarit me tema)*;
  - Integrimi përmes *zbërthimit të objektivave themelorë si lëndë në objektiva specifike*;
  - Gjatë integritit të shfrytëzohen edhe artet, drama, historia, kultura si fusha të sukseshme;
  - Integrimi të mbështetet në mësimin tematik si një kriter tjetër që mundëson dhe që integron shumë fusha të dijes.

## TË MËSUARIT ME TEMA

Nëpërmjet të mësuarit me tema nxënësi nxitet të hulumtojë:

- *Në marrëdhënie të caktuara shoqërore të fushave, të tilla si: familja, shkolla, shoqëria, loja, mësimi, tregtia, detaria, paqja, miqësia etj.*
- *Në identitetin e vet kulturor, nëpërmjet të cilit mund të njohë të djeshmen, të sotmen, traditën, historinë, folklorin e shumë dukuri të tjera të jetës shqiptare.*
- *Në njohjen e mjedisit fizik të gjuhës, dialektin, gjuhën qytetëse, si dhe gjuhën standarde shqipe. Nxënësve u jepet mundësi për të kërkuar dhe për të hulumtuar në burimet dhe rrugët e mundshme që ndikojnë në pasurimin e gjuhës.*
- *Në marrëdhëniet shoqërore përmes të cilave synohet të studiohen dhe të përvetësohen përvoja të tilla nga jeta familjare, e ardhmja e nënësit, për struktura të ndryshme shoqërore, morali i shoqërisë etj.*

## VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe të synojë:

- Sigurimin e informacionit të plotë për arritjet e tyre,
- Përcaktimin e shkallës së përparimit në vazhdimësi të nxënësve,
- Realizimin e objektivave të përcaktuar,
- Nxitjen e nxënësit.

Në klasën e tretë, zbatohet vlerësimi me notë, i cili duhet të shoqërohet në vazhdimësi me vlerësimin me fjalë e shprehje. Në mënyrë të përmblendhur të përdoren këto tipe vlerësimi:

- Vlerësim me gojë;
- Vlerësimi me notë në vazhdimësi;
- Vlerësimi me lista dhe dosje vetjake të nxënësit;
- Vlerësimi përmblendhës e krahasues për punët me shkrim në formë detyrash a testesh për grupe temash, në fund të semestrit dhe në fund të vitit shkollor.

# KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT GJUHA SHQIPE PËR KLASËN E TRETË TË ARSIMIT TË DETYRUAR

## I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Teksti i gjuhës shqipe duhet të udhëhiqet nga disa parime, si në trajtimet konceptuale edhe në formën e paraqitjes së tij.

Hartimi i tekstit “Gjuha shqipe 3” kërkon:

- Respektim të koherencës së plotë me paketën zyrtare të lëndës dhe në veçanti me programin e ri të arsimit 9-vjeçar, të mbështetur në standardet lëndore.
- Reflektimin e përvojës së deritanishme të shkollës tonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera.
- Mbështetjen në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore dhe të metodave më të përparuara bashkëkohore për hartimin e teksteve të mësimin të gjuhëve.
- Pasqyrimin e zhvillimeve të sotme të shoqërisë shqiptare.
- Përshtatjen me moshën e nxënësve dhe interesat e tyre .
- Respektimin e veçorive të zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës 8-9 vjeçar.
- Nxitjen dhe edukimin e qëndrimeve e të vlerave që e mundësojnë nxënësin për të gjetur gjithnjë e më mirë vendin e tij në strukturat sociale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Realizimin e një teksti me karakter fleksibël, duke i lënë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.

Për hartimin e teksteve të gjuhës shqipe me parametra të lartë shkencorë dhe metodikë grupet e autorëve duhet të udhëhiqen nga parime dhe kritere si më poshtë:

- *kritere shkencore,*
- *kritere didaktike,*
- *kritere fizike.*

## II. KRITERE SPECIFIKE PËR HARTIMIN E TEKSTIT “GJUHA SHQIPE 3”

Teksti “Gjuha shqipe 3” do të jetë një tekst i vetëm i cili do të integrojë në përmbajtjen dhe strukturën e tij linjat përbërëse të programit përkatës, si dhe në bashkëveprim edhe me lëndët e tjera.

### 1. Kritere shkencore

Teksti “Gjuha shqipe 3” duhet që:

- të përcjellë saktë, pastër, bukur në përmbajtjen dhe strukturën e tij pasurinë dhe tiparet e gjuhës shqipe.
- të pasqyrojë karakteristikat e gjuhës shqipe dhe identitetin e kombit shqiptar.
- Autorët, përmes tij, të përdorin fjalorin bazë që përvetësojnë fëmijët deri në moshën 8-9 vjeç.
- Fjalori i zgjedhur të përbëjë pjesën më të bukur dhe të freskët të leksikut të gjuhës shqipe.
- Në përshtatje me moshën, të pasyrohen edhe dukuritë e reja sociale që lidhen me jetën e tyre si të drejtat e fëmijëve, shmangien e luftërave, paqen, lumturinë, zhdukjen e varfërisë etj.
- Strukturat e fjalive të jenë të thjeshta, të shkurtra dhe të qarta.
- Fjalët të jenë me gjatësi mesatare dhe teksti të mos ketë mbingarkesë me fjalë shumë të gjata.
- Në mënyrë të natyrshme të pasqyrojë dukuri gjuhësore që gradualisht do të kthehen në shprehje të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit të nxënësve (intonacioni, ndalesat, shkronjat e madhe, shenjat e pikësimit, emrat e njerëzve etj).

- Pjesët për lexim të përfaqësojnë pjesët më të bukura përfaqësuese të letësisë shqipe dhe asaj botërore.
- Në pjesët për lexime të përfaqësohet jo vetëm me tekste letrare por edhe me tekste të natyrës joletrare.
- Pjesët të kënaqësi të përshtatshme për moshën e nxënësve të klasës së tretë.

## 2. Kriteret didaktike që lidhen me hartimin e tekstit “Gjuha shqipe 3”

Për hartimin e tekstit “Gjuha shqipe 3” kërkohet të realizohen dhe respektohen parime dhe kriteret didaktike si më poshtë :

- Të respektohet parimi i integritetit përmes fushave që përbëjnë programin e kësaj lënde: *të folurit, të lexuarit, të shkruarit*, si dhe disa njohuri bazë nga sistemi gjuhësor, të paraqitura në mënyrë intuitive për fëmijët e kësaj moshë.
- Të respektohet parimi tematik i cili lehtëson dhe mundëson respektimin e integritetit brenda dhe ndërlëndor.
- Të bëhet jo vetëm respektimi i parimit linear të vendosjes së temave në mënyrën se si janë paraqitur në program, por vendosjen e tyre, atje ku qëndrojnë dhe shërbejnë më mirë.
- Aparati pedagogjik i çdo mësimi duhet të shoqërohet me rubrikat të pasura të cilat pasyrojnë integritetin, duke shmangur nga teksti modelin e aparateve pedagogjike që kanë pamjen e një grupi pyetjesh të renditura njëra pas tjetrës dhe të veçuara prej njëra-tjetrës.
- Ushtrimet duhet të jenë të larmishme, kryesisht me karakter intuitiv dhe aplikativ me synime dhe objektiva të përcaktuara mësimore që respektojnë gradualitetin në shkallën e vështirësive.
- Rimarrja si një parim didaktik duhet të jetë pjesë e mësimave që do të përbëjnë këtë tekst, me qëllim lidhjen dhe përfortimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.
- Teksti “Gjuha shqipe 3” të jetë një tekst, i cili zhvendos veprimtarinë e mësuesit nga një mësimdhënie me në qendër mësuesin, në një mësimdhënie me në qendër nxënësin.
- Përmes ushtrimeve që do të përbëjnë këtë tekst autorët e tij duhet ta kalojnë mësimdhënien në një mësimdhënie ku nxënësi *kërkon, gjen, zbulon, interpreton, zgjidh, analizon* etj.
- Planifikimi i veprimtarive mësimore, të tilla si: *të lexuarit, të folurit, të shkruarit*, duhet të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti dhe e çdo ore mësimi.
- Punët me shkrim të tipit përshkrim, këshilla, udhëzime të thjeshta, të programuara në programin e kësaj lënde duhet të paraprihen nga modele shumë të qarta, të thjeshta dhe të sakta dhe të ushtrohen nga nxënësit përmes formave të larmishme të punës me to.
- Në aparatet pedagogjike të çdo teme mësimore apo njësie tematike duhet të përfshihen ushtrime me kërkesa për punë me shkrim dhe teknika që i mundësojnë ato.
- Ushtrime dhe forma pune që lidhen me mësimdhënien ndërvepruese duhet të jenë të dukshme në strukturën e aparatit pedagogjik të këtij teksti.
- Të bëhet kujdes në respektimin e raporteve midis pjesës teorike me atë praktike të tij.
- Përmbajtja e tekstit “Gjuha shqipe 3” duhet të mbështetet në parimin intuitiv dhe jo në dhënien e njohurive dhe të koncepteve teorike.
- Materiali gjuhësor e letrar i këtij tekstit duhet të jetë i zgjedhur dhe terheqës me qëllim tërheqjen e interesave të nxënësve për të qëndruar pranë librit .
- Aparatet pedagogjike të këtij teksti të pasyrojnë veprimtarinë që nxisin zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve përmes teknikave dhe strategjive që e mundësojnë .
- Kërkohet që teksti të shoqërohet me foto me ngjyra, *tabela, skica* etj, kur janë të nevojshme dhe të mos përfaqësohet vetëm nga teksti i shkruar.
- Ushtrimet që do të shoqërojnë mësimet në tekst duhet të përfaqësojnë dhe renditen sipas shkallëve të Taksonomisë së Blumit, nga njohja deri tek vlerësimi, me synim rritjen e cilësisë së të nxënësve deri në nivelin e interpretimit, analizës e reflektimit.
- Mësimet që do të zhvillohen në tekstin “Gjuha shqipe 3” kërkohet të kenë paraqitje të lexueshme didaktikisht dhe gjuhësisht.

- Kërkohe të bëhet kujdes në pikëpamje të mbingarkesës mësimore. Thjeshtimi në terma dhe në tekst është një kërkesë tjetër për hartimin e tekstit.
- Çdo mësim do të ketë rreth 2 faqe në të cilat do të përfshihet aparate pedagogjike që zërthejnë pjesët për lexim, si dhe ushtrime aplikative dhe modele të shkruari që përfeksionojnë aftësitë gjuhësore dhe shkruese të nxënësve.
- Pjesë e gjata të leximit është mirë të ndahen në pjesë më të shkurtra.
- Njësitë mësimore tematike në rastet kur do të punohet mbi bazën e këtij parimi mund të ndërtohen duke përfshirë të gjitha linjat që e përbëjnë programin brenda një njësie, por edhe disa prej tyre.

### 3. Paraqitja dhe ilustrimet

- Teksti ‘Gjuha shqipe 3’ duhet të ruajë raporte të drejta didaktike midis figurës dhe fjalës së shkruar.
- Ilustrimet duhet të jenë të qarta, të pastra të lexueshme.
- Ilustrimet të pasqyrojnë botën e fëmijëve: *atë që jetojnë dhe atë të dëshirueshmen, të zhvillojnë imagjinatën e fantazinë.*
- Ilustrimet të nxisin të folurin dhe të pyeturin e fëmijëve për gjëra që ata duan të dinë më tepër.
- Njësia mësimore të ketë një organizim didaktik edhe për nga ana e kompozimit figurativ; faqosjes, titujve, nëntitujve, figurave të tjera ndihmëse; *simboleve e shenjave.*
- Përmes figurës, të lexohen zgjidhjet didaktike të gjetura si për metodat, ashtu edhe për rubrikat e tjera të aparatit pedagogjik.

Teksti të jetë me 240 faqe A4, si dhe me katër ngjyra

Formati të jetë: 260 x 200 mm.